

V E N D I M
Nr.40, datë 6.5.1999

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë e përbërë nga :

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Hilmi Dakli,	Anëtar i “““
Zija Vuci,	Anëtar i “““
Bardha Selenica,	Anëtare e “““
Kristofor Peçi,	Anëtar i “““
Sokol Sadushi,	Anëtar i “““
Kujtim Puto,	Anëtar i “““

Me sekretare Arbenka Lalica, më datë 6.5.1999, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura kërkesën me nr.41 Akti që i përket :

K Ë R K U E S E: SHOQATA E JURISTËVE TË SHQIPËRISË “DURA LEX, SED LEX”, e përfaqësuar nga kryetari zoti Luan Hamiti dhe avokati Sadedin Xhafo, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. KËSHILLI I LARTË I DREJTËSISË
2. KËSHILLI I MINISTRAVE, të përfaqësuar nga zoti Thimjo Kondi, Zëvendëskryetar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe Ministër i Drejtësisë.
- 3.KUVENDI, i përfaqësuar nga zotërinjtë Veli Budo e Viktor Gumi.

O B J E K T I :

Shpallja antikushtetues e nenit 48 të Ligjit nr.8436, datë 18.12.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.

Kërkuesi ka parashtruar këto shkaqe për shpalljen antikushtetues të Ligjit:

1. Neni 48 i Ligjit nr.8436, datë 18.12.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” vjen në kundërshtim me Kushtetutën në fuqi (nenin 138), sepse koha e qëndrimit të gjyqtarëve nuk mund të kufizohet;
2. Cënohet parimi i barazisë duke u detyruar vetëm gjyqtarët me stazh deri 10 vjet të japin provim. Këta të fundit diskriminohen në raport me gjyqtarët e tjerë;
3. Ligji në fjalë vjen në kundërshtim me aktet e Këshillit të Europës si ai për ruajtjen e statusit të gjyqtarëve;
4. Ligji në fjalë vjen në kundërshtim me nenin 57/7 të Kushtetutës, sepse prek autonominë e institucioneve të arsimit të lartë.
5. Pamjaftueshmëria profesionale sipas Kushtetutës është e sanksionuar në nenin 45 të Ligjit “Për organizimin e drejtësisë në Republikën e Shqipërisë” dhe jo në nenin 48 që është normë procedurale;
6. Duhet të pezullohet dhënia e provimit, sepse humbet kuptimi i dhënies së vendimit gjyqësor si dhe i zbatimit të ligjit.

GJYKATA KUSHTETUESE,

Pasi dëgjoi kërkesat paraprake të palës kërkuese, të përfaqësuesve të subjekteve të interesuara dhe bisedoi çështjen,

V Ë R E N :

Kërkesa e Shoqatës së Juristëve të Shqipërisë “Dura Lex, Sed Lex” e nënshkruar nga Kryetari i saj Luan Hamiti është paraqitur në Gjykatën Kushtetuese në datën 10.4.1999. Po në këtë datë kjo Gjykatë i kthen me shkresë kërkesën, duke i kërkuar të bëhen plotësimet e dokumentacionit ndërmjet të tjerave edhe me Statutin e Shoqatës e me vendimin e gjykatës për miratimin e saj.

Kërkesa e plotësuar u paraqit përsëri në datën 4.5.1999.

Sipas nenit 9 të Statutit, organet drejtuese të Shoqatës janë Mbledhja e Përgjithshme dhe Këshilli Drejtues, ndërsa sipas nenit 11/4 të tij veprimtaria e përgjithshme e Shoqatës dhe ajo që lind

gjatë një-dy muajve drejtohet nga Kryetari dhe Sekretari i Përgjithshëm. Pra, siç shihet, statuti udhëhiqet nga parimi i kolegjalitetit si në ndërtimin e organeve të tij ashtu edhe në veprimtarinë e këtyre organeve. Në periudhën midis dy Mbledhjeve të Përgjithshme, ai ka ngarkuar Këshillin Drejtues të drejtojë veprimtarinë e Shoqatës ndërsa për “veprimtarinë e përgjithshme” dhe për ato probleme që dalin gjatë periudhës midis dy mbledhjeve të Këshillit, statuti ka ngarkuar jo vetëm Kryetarin dhe as vetëm Sekretarin e Përgjithshëm, por të dy së bashku.

Në çështjen në shqyrtim nuk ka ndonjë vendim të organeve drejtuese të Shoqatës, Mbledhjes së Përgjithshme ose Këshillit Drejtues për të ngritur padi në Gjykatën Kushtetuese, me objekt papajtueshmërinë me Kushtetutën të nenit 48 të Ligjit nr.8436, datë 28.12.1998, siç kërkon neni 47 i Kodit Civil dhe as kërkesë të përbashkët të Kryetarit e Sekretarit të Përgjithshëm siç lejon neni 11/4 i Statutit të Shoqatës. Ka vetëm një kërkesë të nënshkruar nga Kryetari i Shoqatës dhe një prokurë me të cilën ka caktuar avokat të nënshkruar po prej tij.

Duke qëndruar çështja si më sipër, vetëm kryetari i shoqatës duke mos qenë përfaqësuesi i saj, sipas Kodit Civil e Statutit të Shoqatës, nuk legjitimohet të vejë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese në kuptim të nenit 134 të Kushtetutës.

Për këto arsye, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 41 të Ligjit nr.8373, datë 15.7.1998 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

V E N D O S I:

Rrëzimin e kërkesës për mungesë legjitimitimi.

Ky vendim është i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më 6.5.1999

Nr. 41 i regjistrimit themeltar.

Nr. 40 i vendimit.